

Kryeministri shqiptar Edi Rama ka deklaruar se bashkimi i Shqipërisë me Kosovën nuk mund të përjashtohet nëse prespektiva për anëtarësimin e Ballkanit në BE venitet.

Në një intervistë për “Politico”, Rama ka paralajmëruar se “Europa mund të përballët me një makth” nëse vendet e Ballkanit “çmenden” si pasojë e nxjerrjes së zgjerimit jashtë agjendës së Unionit, transmeton Top Channel, përcjellë Klan Kosova.

“Rajoni do të kthehet në një zonë gri ku aktorë të tjerë do të jenë më influentë sesa Bashkimi European”, ka thënë Rama.

I pyetur nëse do të bëjë një bashkim me Kosovën në mënyrë të njëanshme, Rama është përgjigjur: “Jo, sepse mënyra e vetme për të ruajtur paqen në Ballkan është që shtegu drejt BE-së të jetë i hapur, që perspektiva të jetë e qartë dhe që ndjenjat karshi BE-së të jenë pozitive”.

“Askush nuk do të shohë drejt unioneve më të vogla. Të gjithë duan që të bashkohen në Unionin e madh. Por nëse nuk ka shpresë, nuk ka perspektivë dhe nuk ka hapësirë, atëherë bashkimet e vogla mund të ndodhin”, ka thënë Rama.

Kreu i qeverisë shqiptare ka theksuar se bashkimi me Kosovën nuk është dëshira e tij, por një alternativë ndaj mbylljes së dyerve nga Bashkimi European.

Rama ka paralajmëruar se, ndalimi i procesit të zgjerimit mund të destabilizojë Europën, duke theksuar se, “kjo alternativë do të ishte një makth për popullin dhe vendet e Europës”.

“Ka mungesë kuptimi dhe vizioni, se ky rajon ka nevojë për Europën, por edhe Europa ka nevojë për të, për një Europë më të sigurtë”, ka thënë Rama.

“Si mund të jetë Unioni më i sigurtë nëse Ballkani çmendet? Si mundet që Bashkimi European të lejojë krijimin e një zone gri në zemër të kontinentit, ku aktorë të tjerë mund të kenë më shumë influencë se vetë BE-ja? Kjo është diçka e pakuptimtë në aspektin e sigurisë”, ka shtuar Rama.